



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr. _____ / 2018

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 171/2014 “PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE TË KALIMIT TË
TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË
PRONËSI TË PËRFITUESVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1, dhe 83 pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të deputetit Erjon Braçe

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pika 1, shkronja a), bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nënshkronjën ii), fjalët “dhe prej datës 1.10.1992 nuk kanë ndryshuar vendbanimin e tyre, sipas regjistrit të gjendjes civile” shfuqizohen.

2. Nënshkronja iii) ndryshon me këtë përmbajtje:

“iii) e përdorin tokën për veprimtari bujqësore dhe që disponojnë aktin e marrjes së tokës në përdorim, të rregjistruar deri më datë 31.12.1993 në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) së Qarkut ose në Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) së Bashkisë. Këto familje duhet të vërtetojnë me dokumenta zyrtarë të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) së Qarkut, nga Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) së Bashkisë ose nga Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), të njësisë së qeverisjes vendore nga ku kanë ardhur se nuk kanë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo në pronësi në qendrat e tyre të mëparshme të banimit.

3. Pas nënshkronjës iii) shtohen nënshkronjat iv) dhe v) me këtë përmbajtje:

“iv) e përdorin tokën për veprimtari bujqësore, por nuk e disponojnë aktin e marrjes së tokës në përdorim dhe nuk kanë të rregjistruar tokë në përdorim ose pronësi në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) së Qarkut ose në Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) së Bashkisë përkatëse. Për këto familje bujqësore ose individë do të zbatohen kriteret e VKM-së nr.452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, vetëm mbasi të vërtetojnë me dokumenta zyrtarë se nuk kanë përfituar tokë bujqësore në përdorim ose në pronësi në njësinë e qeverisjes vendore ku kanë pasur vendbanim të përhershëm deri në datën 01.02.1991.”

“v) e përdorin tokën për veprimtari bujqësore dhe që e disponojnë aktin e marrjes së tokës në përdorim, të lëshuar mbas datës 31.12.1993, por nuk plotësojnë kërkesat e VKM-së nr.452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar, toka do ti mbetet në përdorim.”

Neni 2

Në nenin 6 “Afati përfundimtar”, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve mbyllet në datën 30 qershor 2019.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI